

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetares së trupit gjykues Emine Salihu, gjyqtarëve Luljetë Shabani dhe Afrim Shala, anëtarë, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. F.nga Gj., të cilin sipas autorizimit e mbron avokatja S. M. nga Gj., ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan, PP.nr.86/2007 të datës 05.05.2010, të cilën e përfaqësonte prokurori Mr.sc.Isuf Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, më datën 14.10.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë :

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri A. F., nga babai S., dhe nëna S. e lindur S., i lindur më datë ..., në Gj., ku edhe jeton me adresë në rr. “...” nr..., me vendqëndrim në ... në adresë ..., ..., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, ka të kryer shollën e mesme, punëtor në ..., i martuar, babë i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë .

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më datë ... .2007, rreth orës ...h, në Gj., derisa ndodhej me të pandehurit sikurse në aktakuzë në kafetereinë “...” në Lagjen “...”, e ndihmon të akuzuarin I. Y., në kryerjen e veprës penale si në dispozitivin I të aktakuzës ashtu që ia jep automjetin ..., me tabela të regjistrimit ..., ku i akuziari në fjalë me automjetin e cekur shkon në shtëpinë e tij në Lagjen “...”, e merr pushkën automatike ... dhe kryen veprën penale, duke qenë i ndihmuar nga i akuzuari sikurse në dispozitivin I të aktakuzës,

Me këtë ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së,

Andaj, trupit gjykues në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75 ,76,83 dhe 83 të KPRK-së, si dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>1</sup> të pandehurit i shqipton :

---

<sup>1</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

## DËNIM ME BURGIM I CILI ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ËSHTË ZËVENDËSUAR NË DËNIM ME GJOBË

- Ashtu që të pandehurit A. F. , për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së, silurse në dispozitiv të aktgjykimit ( dispozitivit III i aktakuzës PP.nr.86/2007 të datës 05.05.2010) i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.
- Me pëlqimin e të pandehurit A. F., dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën 3.000.00 €(tre mijë euro, në të cilin dënim ka me iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ... .2007 e deri më date ... .2007 , ashtu që një ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 20 euro të dënimit me gjobë, (koha e kaluar në paraburgim kap shumën 1180 (njëmijë e njëqindë e tetëdhjetë ) €.
- Ashtu që I akuzuari A. F.ka për të paguar dënimin me gjobë në shumën e vetëm prej 1800 (njëmijë e tetëqind) €.
- Dënimin me gjobë në shumë prej 1800 € i pandehuri ka për ta paguar, menjëherë meqenëse aktgjykimi është i plotëfuqishëm ditën e komunikimit, dhe nëse i pandehuri refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.
- Aktgjykimi bëhet i plotëfuqishëm ditën e komunikimit më datë 14.10.2016, meqenëse palët kanë hequr dorë nga ankesa.
- Detyrohet i pandehuri A. F., që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

#### 1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Publike e Qarkut në Gjiilan, , më datë 05.05.2010 ka ngritur aktakuzë PP.nr.86/2007 , ndaj të pandehurëve I. Y.nga Gj. për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nën paragrafi 4 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 të KPK-së, ndaj të pandehurit A. F. për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 20 e 25 të KPK-së , të pandehurit B. O. për shkak të veprës penale kanosje nga neni 161 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 e 1 të KPK-së dhe të pandehurit A. Y. për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve

pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

Me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës, me aktvendimin PKR.nr.46/13 të datës 12.02.2015 ndaj të pandehurve A. F. dhe B. O. është veçuar procedura penale për të cilët do të zhvillohet ndaras.

Më datë 03.12.2015, në gjykatë, është dorëzuar një marrëveshje për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, në njërën anë dhe të pandehurit A. F. dhe mbrojtësit të tij, avokates S. M. nga Gj., në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate, i është rekomanduar që ndaj të pandehurit A. F., për shkak të kryerjes së veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet : dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi të zëvendësimit me dënim me gjobë, ndërsa në dënimin e shqiptuar ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.10.2016 Prokuroria Themelore në Gjilan/Departamenti për Krime të Rënda, prokurori Mr.sc.Isuf Sadiku, ka bërë rikualifikimin e veprës penale sipas aktakuzës së lartpërmendur dhe sipas këtij rikualifikimi të pandehurit i është ngarkuar vepra penale e ndihmës në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së, dhe në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur dhe të ndryshuar sa i përket cilësimit juridik si dhe marrëveshjes së lidhur ndërmjet prokurorisë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, duke i propozuar gjykatës që ta pranojë të njëjtën, sikurse edhe dënimin e rekomanduar.

Mbrojtësja e të pandehurit av.S. M. dhe i pandehuri A. F., e kanë përkrahur propozimin e prokurorit të shtetit, duke u deklaruar se për të njëjtën kanë hyrë në marrëveshje me vullnetin e tyre, dhe pajtohen me rekomandimin.

## 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 14.10.2016, kryetarja e trupit gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtëses së pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetarja e trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri me vullnetin e tij ka hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë; se marrëveshja për pranimin e fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësen e tij, avokaten S. M.; se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë dhe hyjë në marrëveshje; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanta e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

Mbrojtësja e të pandehurit av.S. M. dhe i pandehuri A. F., pas aprovimit të marrëveshjes për pranimit të fajësisë dhe shpalljes së dënimin në dënim unik me

burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj, i kanë propozuar gjykatës që në pajtim me nenin 47 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muaj të zëvendësohet në dënim me gjobë.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetarja e trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri A. F., me dashje e ka kryer veprën penale: ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës.

### 4. Elementet e veprave penale

Në nenin 146 paragrafi të KPK, është parashikuar se forma themelore e veprës penale të vrasjes e kryen “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim” ndërsa në nenin 20 të KPK-së është paraparë edhe veprimet për veprën penale të mbetur në tentative sipas së cilës Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale përderisa sipas paragrafit 3 të këtij neni rezulton se “Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65 (2) të këtij Kodi. Kurse në nenin 25 të po këtij Kodi veprën penale të ndihmës konsiderohet se e ka kryer ‘’ Kushdo që me dashje e ndihmon tjetrin të kryejë vepër penale përderisa ndihma për të kryer një vepër penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t’i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale

Kryetarja e trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin A. F., për shkak të veprave penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 e 25 të KPK-së , ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë i pandehuri dhe ka hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për të njëjtën se: më datë .. 2007, rreth orës ...h, në Gj., derisa ndodhej (me të pandehurit) në kafiterinë “...”, në Lagjen “...”, e ndihmon të akuzuarin I. Y., në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë ashtu që ia jep automjetin ..., me tabela të regjistrimit ..., me të cilin i pandehuri me këtë automjet shkon në shtëpinë e tij në Lagjen “...”, e merr pushkën automatike ... dhe kryen veprën penale.

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetarja e trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit A. F., për veprën penale të lartë përmendur, dhe të shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me burg me propozimin e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij u zëvendësua në dënim me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, kryetarja e trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 deri 76 të KPRK-së. Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetarja e trupit gjykues e ka shqiptuar dënimin, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda. Gjithashtu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se i pandehuri është pënuar thellë për kryerjen e kësaj veprave penale; se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetarja e trupit gjykues ia fali besimin, kjo është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe ka premtuar se më nuk do të kryejë vepra penale, se është i martuar dhe prind i ... fëmijëve. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale. Ndërsa, si rrethana rënduese, kryetarja e trupit gjykues e ka marrë për bazë peshën dhe rrezikshmërinë e veprës penale .

## 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetares së trupit gjykues, dënimi me gjobë në shumë prej 3.000.00 €(tre mijë euro ), në të cilin dënim ka me iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ... .2007 e deri më datë ... .2007) ndaj të pandehurit A. F., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetarja e trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit.

Kryetarja e trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## 7. Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar me burgim

Duke u bazuar në nenin 83 paragrafi 1 dhe 4 të KPRK, sipas së cilës koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale , llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë, kryetarja e trupit gjykues ka vendosur që në dënimin e shqiptuar me gjobë, të pandehurit A. F., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës ... .2007 e deri më datën ... .2007, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 20 euro të dënimit me gjobë.

#### 8. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Sipas nenit 47 i KPRK, kur gjykata shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, lejon që gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet në dënim me gjobë me pëlqimin e të akuzuarit. Ndërsa në anën tjetër i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë dhënë pëlqimin dhe kanë propozuar që i njëjti të zëvendësohet për çka edhe kryetarja e trupit gjykues ka marrë një vendim të tillë meqenëse sipas aktgjykimit për veprën penale për të cilën e shpalli fajtorë sipas aktgjykimit, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe në këtë kohëzgjatje të dënimit dispozita ligjore mundëson zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë dhe përkitazi me këtë të pandehurit iu shqiptua dënimi me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë ) euro.

#### 8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetarja e trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK –së, ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 6 muaj.

#### 10.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro si dh shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PKR.nr.130/16**  
**Më 14.10.2016**

Sekretare juridike,  
Fatmire Sermaxhaj,d.v,

Kryetarja e trupit gjykues ,  
Emine Salihu,d.v,

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë meqenëse palët kanë hequr dorë nga ankesa.